

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË SELENICË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkia Selenicë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 30.04.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 95, datë 22.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 484/6, datë 20.10.2015, i ka rekomanduar z.Ferdinand Algjoni, Kryetar i Bashkisë Selenicë, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nuk është plotësuar ditari i veprimeve të ndryshme dhe nuk është realizuar përmbledhja e llogarive në centralizator apo libër të madh, për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore (2013-2014).

- Nuk janë të përfshira në bilanc 35 pronat e transferuara nga pushteti qendror në pronësi të Bashkisë Selenicë, të cilat janë të regjistruara në ZVRPP Vlorë.

- Në aktiv të bilancit të vitit 2013, nuk janë pasqyruar shpenzime në proces, në llogarinë nr. 231, “Shpenzime në proces”, në vlerën 13,409,128 lekë, për punime të kryera në fushën e investimeve.

-Në aktivin e bilancit të vitit 2013-2014 në llogarinë nr. 477 “Diferenca konvertimi aktive” me pozicion financiarë 10,774,809 lekë, është e pa mbështetur me artikull kontabël.

-Llogaria nr. 468, “ Debitorë në persona ” për vlerën 6,098,685 lekë e trashëguar nga viti 2012, nuk është pasqyruar dinamika dhe nuk është reflektuar në kontabilitet shlyerja e detyrimeve të prapambetura, për llogari të viteve të mëparshme.

**Rekomandim:** Përgjegjësi i Zyrës Financës të marrë masa, për organizimin e mbajtjes së kontabilitetit, duke respektuar azhurnimin e të gjithë artikujve kontabël në ditarët e kontabilitetit, plotësimin e ditarit të veprimeve të ndryshme dhe plotësimin e librit të madh, si dhe të marrë masa për analizimin dhe kryerjen e veprimeve kontabël të llogarisë nr. 477, “Diferenca konvertimi aktive” me pozicion financiarë vlerë 10,774,809 lekë, në bilancin e vitit 2014 i pa mbështetur me artikuj kontabël.

***Brenda muajit Tetor 2015***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë kryer të gjithë hapat e nevojshme ligjore, të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, për regjistrimin e këtyre pronave në ZVRPP Vlorë, në pronësi të Bashkisë Selenicë, ku janë regjistruar 56 pasuri të paluajtshme nga 109, pra 50% të aseteve të transferuara me VKM nr. 195, datë 06.03.2013. Nuk janë krijuar regjistra të veçantë për regjistrimin e pronave të paluajtshme të transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë, për të pasqyruar ndryshimet, pas kalimit përfundimtar me Vendimin nr. 673, datë 21.05.2008 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Selenicë, të Qarkut Vlorë*” .

**Rekomandim:** Bashkia Selenicë të marrë masa për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Selenicë, në zbatim të akteve nënligjore.

***Brenda muajit Nëntor 2015***

**3.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Selenicë ka lidhur kontrata qiraje me të tretë, me objekt shfrytëzim karriere (rërë bituminoze) në **3 raste**, konkretisht me subjektet: “Selenicë Bitumi”, “Mineral Bitumen”, dhe nënkontraktorin “A..&K...E” sh.p.k., të cilët kanë shkelur marrëdhëniet kontraktuale, duke mos shlyer në total detyrimet, ndaj bashkisë në vlerën **19,425,935** lekë. Në këto kushte kur janë shkelur marrëdhëniet kontraktuale nga subjektet “Selenicë Bitumi” sh.a dhe “M....B....”sh.p.k.

**Rekomandim:** Bashkia Selenicë për tre subjektet të parregullt në shlyerjen e detyrimeve kontraktuale, që kanë sjell dëm në buxhetin e bashkisë, “Selenicë Bitumi”, sh.p.k, “Mineral

Bitumen”sh.p.k dhe nënkontraktorin “A.... &K.....E” sh.p.k, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore duke kërkuar gjyqësish falimentimin e tyre.

Bashkia Selenicë të marrë masa, për të rakorduar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë për rentën minerale për subjektet “S.... B”, sh.p.k“ M..... B ”sh.p.k dhe nënkontraktorin “A.....&...E

**Brenda muajit Shtator 2015**

### **A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, Kryetari i Bashkisë Selenicë, të nxjerrë aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohej **shpërblimi i dëmit në vlerën 32,017,457 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:**-Në **3 raste**, janë kryer pagesa tepër për punonjës të bashkisë me efekte financiare në dëm të buxhetit të saj në vlerën 96,342 lekë .

**Rekomandim:** Bashkia Selenicë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe administrative për shpërblimin e dëmit në vlerën 96,342 lekë nga personat përgjegjës.

**Brenda muajit Nëntor 2015**

**2. Gjetje nga auditimi:** Anëtarët e KVO, Gj. Xh, O. M dhe M. P. kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore, për skualifikimin në kundërshtim me nenin 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, të OE ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim dhe duke përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave.

**Rekomandim:** Bashkia Selenicë të marrë masa, të kontabilizojë dhe kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **prej 325,500 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit në ngarkim të znj. Gj. Xh, O. M dhe M. P, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Brenda muajit Nëntor 2015**

**3. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se dy subjekte të biznesit të madh me aktivitetet minerar, “H..In.....” dhe “R.....” shpk, Bashkia Selenicë nuk ka mundur të lidh kontrata qeraje (*trajtuar dhe në auditimin e mëparshëm të KLSH*), për detyrimin që rrjedh nga shfrytëzimi i sipërfaqes së zonës së lejuar minerare për vitet 2013-2014, në vlerën **12,133,680 lekë**. Bashkia Selenicë nuk ka zbatuar kërkesat e neneve 90 dhe 91 të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Rekomandim:** Bashkia Selenicë të marrë masa, të kontabilizojë dhe kërkojë arkëtimin e detyrimeve në vlerën **12,133,680 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore. Të njoftohen zyrtarisht të gjithë strukturat shtetërore përgjegjëse dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit, referuar dispozitave ligjore, për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet:

-“H.... I....” shpk vlerën **3,456,840 lekë**.

-“R.....” shpk vlerë **8,676,840 lekë**.

**Brenda muajit Shtator 2015**

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Selenicë ka lidhur kontrata qiraje me të tretë, me objekt shfrytëzim karriere (rërë bituminoze) në **3 raste**, konkretisht me subjektet:

-“S.. B” Sh.a me leje shfrytëzim nr. 355, datë 17.06.1997.

-“M...B.....”, me leje shfrytëzimi nr. 1371, datë 22.6.2009

- nënkontraktorin “A.....&K.... .....E” sh.p.k.

Nga auditimi u konstatuan shkelje dhe mangësi me efekt dëm financiar për NJQV, Bashkia Selenicë, konkretisht:

- **Detyrime financiare të subjekteve “S.....B.....” Sh.a, “Mineral Bitumen”:**

<b>Përshkrimi i detyrimeve</b>	<b>Lekë</b>
Detyrim prapambetur kontraktual	7,698,603
Kamata vonesa	769,810
Përlllogari të nën/kontraktorit “A...&K.....”	6,372,000
Kamatë vonesa nga nën/kontraktori	637,200
Për sa zbritur për punësim dhe investime të pa dokumentuara	3,948,322
<b>Totali i detyrimit</b>	<b>19,425,935</b>

**Rekomandim:** Bashkia Selenicë të marrë masa, të kontabilizojë dhe kërkojë arkëtimin e detyrimeve në vlerën **19,425,935 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore, si dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjyqimit për pagesën e detyrimeve, përkatësisht:

a. S...B.... sh.p.k **vlera 10,125,030 lekë**.

b. M...B.... sh.p.k **vlera 2,291,705 lekë**.

c. A.... K.. E sh.p.k **vlera 7,009,200 lekë**.

Bashkia Selenicë të marrë masa, për të rakorduar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë , për llogaritjen dhe arkëtimin e rentës minerale nga subjektet e mësipërme.

*Brenda muajit Nëntor 2015*

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Selenicë, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i kemi rekomanduar Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Kreu X i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar:

**1.1** Të shqyrtojë dhe të marrë masë “Gjobë” ndaj anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, *konkretisht:*

1. z. E.RR, 2. z. A.DH, 3. znj. S.S, 4. z. P.K, 5. z. L. H, 6. z. K,Lli

**1.2** Të shqyrtojë dhe të marrë masë vendosje “Gjobë”, ndaj anëtarëve të Komisioni Vlerësimit të Ofertave, *konkretisht:*

1. znj. Gj.Xh, 2. znj. M,P dhe 3. znj. O,M

Në vlerësimin e kryer mbi zbatimin e standardeve dhe cilësinë e auditimit, puna e kryer nga grupi i auditimit, vlerësohet e dobët nga Kryetari i KLSH dhe kjo dosje do të kalojë në kontroll në të ftohtë, për një rivlerësim dhe rishikim të pikave të programit që nuk janë realizuar plotësisht, si dhe nëse do jetë nevoja do të kryhet auditim në Bashkinë Selenicë me grup tjetër audituesish shtetëror.

Nga Bashkia Selenicë, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Pal Daçi, Berti Meçaj, Julian Adili dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**